



Datë: 06.03.2026
Numër Protokolli: 1185/2026

A.nr.1808/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, më Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.1808/2025, të datës 17.10.2025, të parashtruar nga ankuesi E.S,kundër organit të punësimit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më objekt ankimor “*anulim i vendimit*” duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1808/2025, e datës 17.10.2025, e parashtruar nga ankuesi, E.S.

II.Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 0211-2885-2025, i datës 14.10.2025, i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa, lënda kthehet **në rishqyrtim** dhe **rivendosje**.

III.Obligohet Udhëheqësi i Departamentit për Operacione Zgjedhore, Edukim, Informim, Analiza dhe Trajnime që në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses të trajtoj çështjen e ankuesit në pajtim më pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

IV.Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, E.S, (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), më datë 17.10.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 0211-2885-2025, të datës 14.10.2025, të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendror.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, ndërsa, ky i fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6855/2025, të datës 17.10.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë pune me kohë të caktuar e lëshuar nga KQZ, me numër Nr.160/2025, të datës 25.01.2025; Aneks Kontratë me numër Nr.160/2025, e datës 27.01.2025; Vendim për anulim të kontratës me numër Nr.160/2025, me numër protokolli Nr.0211-2885-2025, të datës 14.10.2025; Kopjen e letërnjoftimi të ankuesit E.S; Formularin e parashtrimit të ankesës, të datës 17.10.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.10.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Rregullore e brendshme Nr.05/2024, Kodi i etikës për Zyrtarët Publik në KQ.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe së çështja duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosije*, sepse:

I. Vlerësimi i gjendjes së fakteve

Bazuar në shkresat e lëndës rezultojnë se:

- Ankuesi sipas Kontratës së Punës për periudhën e caktuar kohore me numër Nr.160/2025, të datës 25.01.2025, ka themeluar marrëdhënie e pune në KQZ në pozitën e punës Zyrtar i Logjistikës në Depo dhe QNR, në Departamentin për Operacione Zgjedhore, Edukim, Informim, Analiza dhe Trajnime, në kohëzgjatje prej 27.01.2025 deri 28.02.2025, më mundësi vazhdimi. Ndërsa, më Aneks kontratën e datës 18.08.2025, është vazhduar angazhimi i ankuesit nga data 19.08.2025 deri 31.10.2025, më mundësi vazhdimi më së shumti 3 vite.

- Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve, më Vendimin me numër protokolli Nr.0211-2885-2025, të datës 14.10.2025, ka anuluar Kontratën e Punës Nr.160/2025, të datës 25.01.2025, të lidhur mes ankuesit dhe KQZ-së, më arsyetimin se: *Divizioni i Burimeve Njerëzore më datë 12.10.2025, ka pranuar më shkrim fakte për shkelje të kodit të mirësjelljes nga i punësuari z. Selmani, i cili në ditën e zgjedhjeve është parë në turmën e njerëzve duke manifestuar, shpërndarë flamuj partiak të një subjekti politik dhe duke brohoritur një prej*

kandidateve për kryetar të Komunës së Prishtinës.... Për më shumë personeli i përhershëm dhe përkohshëm i KQZ-së duke të përmbahet nga do veprim i cili shfaqet publikisht bindjet personale politike, pasi që është Institucion përgjegjës për organizmin e zgjedhjeve.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi kundërshton Vendimin më numër protokolli 0211-2458-2025 të datës 20.09.2025, për shkëputje të njëanshme të marrëdhënies së punës, duke pretenduar së akti është i kundërligjshëm, sepse në momentin kur është pretenduar së kam qenë në aktivitet politik nuk kam qenë në orar pune dhe se regjistrimet e vijueshmërisë në punë e arsyetojnë këtë fakt. Shton se e drejta për të shprehur bindje politike dhe për të marr pjesë në aktivitete poetike është e garantuar me nenin 25, paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe se institucioni para marrjes së vendimit nuk më ka njoftuar paraprakisht dhe nuk i ka dhënë mundësinë e dëgjimit dhe shpjegimit, çka përben shkelje të së drejtës së mbrojtjes në procedurë administrative. Kërkon që KPMSHCK-ja ta shfuqizoj vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe ankuesin ta rikthej në pozitën e mëparshme më të gjitha të drejtat dhe përfitimet që burojnë nga ajo.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “4. *Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë*”, kështu që, nisur nga ky përcaktim ligjor rrjedhë fakti i pa kontestuar së të punësuarit në administratën e Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në referencë të këtij përcaktimi ligjor, me akte të veçante ligjor ka rregulluar procedurën e pranimit të përhershëm dhe përkohshëm të nëpunësve civilë në këtë institucion, si dhe lidhur me çështje të tjera referuar të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës.

Kështu që, nisur nga ky referim ligjor, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit, fillimisht i 'u referua legjislacionit në fuqi sipas të cilit ankuesi ka lidh marrëdhënie punë më KQZ-në respektivisht Rregullores (KQZ) NR.02/2024 për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, e më të cilën është përcaktuar se:

- Neni 1: *Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për themelimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil me kontratë për një periudhë të caktuar në KQZ.*
- Neni 2: *1. Kjo Rregullore zbatohet nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ) dhe Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra), dhe përcakton procedurat për pranimin e personelit të përkohshëm: 1.1. Ndihmës, administrativ, teknik dhe mbështetës; 1.2. profesional.*
- Neni 3 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1: *1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë këtë kuptim: 1.1. Personel i përkohshëm, nënkupton personelin në nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të*

paragrafit 1 të nenit 2 të kësaj Rregullore, që rekrutohet për realizimin e projekteve të caktuara apo për plotësimin e një pozite, në rast të mungesës së përkohshme në KQZ.

- Neni 4: *1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore, kanë këtë kuptim: 1.1. Personel i përkohshëm, nënkupton personelin në nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të paragrafit 1 të nenit 2 të kësaj Rregullore, që rekrutohet për realizimin e projekteve të caktuara apo për plotësimin e një pozite, në rast të mungesës së përkohshme në KQZ.*

- Neni 5: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar për realizimin e një projekti të caktuar. 2. Projekti sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të aprovohet nga KQZ dhe të ketë mbulesë financiare në buxhet. 3. Përshkrimi i projektit sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë të paktën kohëzgjatjen e projektit, koston e detajuar, numrin e punëtorëve që do të angazhohen, pagesën e tyre.*

- Neni 26: *1. NJMBNJ, pas kryerjes të verifikimit, lidh kontratën me kandidatin në pozitën në të cilën ka aplikuar respektivisht në pozitën e përzgjedhur nga ai. 2. Pas nënshkrimit të kontratës, kandidati fitues duhet të paraqitet në KQZ, jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e nënshkrimit. Ky afat mund të zgjatet me kërkesë të kandidatit, për shkaqe të arsyeshme dhe me pajtimin e KQZ deri në dhjetë (10) ditë, duke përfshirë afatin fillestar. 3. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit të emëruar, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, NJMBNJ ndërpret kontratën. 4. Kontrata nënshkruhet nga NJMBNJ dhe kandidati sipas legjislacionit përkatës të punës. 5. Kontrata e punës, për punësimin e personelit të përkohshëm për realizimin e projektit të caktuar të KQZ, sipas paragrafit 3.1 të nenit 37 të LQP, lidhet për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se tre (3) vite. 6. Kontrata e punës, për punësimin e personelit të përkohshëm për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme në KQZ, sipas paragrafit 3.2 të nenit 37 të LQP, lidhet për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më të gjatë se dy (2) vite. 7. **Personeli i përkohshëm i punësuar me kontratë sipas paragrafit 5 dhe 6 të këtij neni, gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të gjithë nëpunësit civil në KQZ, me përjashtim të së drejtës për vazhdim të kontratës së përkohshme, pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit.***

Rrjedhimisht, duke u bazuar në kuadrin ligjor si më sipër, rezulton konstatimi se personeli i përkohshëm i punësuar në Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve, në këtë rast edhe ankuesi gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet sikurse të gjithë nëpunësit civil pranë këtij institucioni, përveç të drejtës për vazhdimin e kontratës së përkohshme, pa i nënshtruar procedurës së rregullt të rekrutimit, e mbi këtë nënkuptim, rrjedhë fakti se çështjet referuar ndërprerjes-përfundimit të marrëdhënies së punës të personelit të përkohshëm i nënshtrohen dispozitave në fuqi të aplikuara për të gjithë nëpunësit civil e që kanë të bëjnë me përfundimin të marrëdhënies së punës në shërbim civil, fakt ky i paraparë edhe në nenin 8 të kontratës së punës nr.16/2025 të datës 25.01.2025. Rrjedhimisht, përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbim civil behët vetëm në pajtim me dispozitat ligjore të kapitullit V të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, ndërsa shkëputja e një kontratë administrative mund të behët vetëm sipas kushteve ligjore të parapara me nenin 66 të LPPA-së.

Në fakt, duke qenë së shkakut i ndërprerjes së marrëdhënies së punës së ankuesit i referohet shkeljes së Kodit të Etikës, shkelje kjo që sipas nenit 56, paragrafi 4.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 7 të Rregullores KQZ-së Nr. 04/2024 për Disiplinën e Zyrtarëve Publik në KQZ, cilësohen si shkelje e rëndë disiplinore, atëherë, organi i punësimit ka qenë i detyruar që trajtimin dhe konstatimin e shkeljes së pretenduar disiplinore ta bëjë vetëm përmes ndjekjes së procedurë së përcaktuar më Rregulloren e Brendshme të KQZ-së Nr. 04/2024 për Disiplinën e Zyrtarëve Publik në KQZ.

Rrjedhimisht, nga analizimi aktit të kundërshtuar Kolegji ka vërtetuar së ndërprerja e marrëdhënies së punës së ankuesit ishte bërë në mënyrë të njëanshme përmes anulimit të kontratës dhe mbi bazën ligjore të nenit 32 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik (shmangia e konfliktit të interesit), nenit 5 të Ligjit 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik(Parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit) dhe Rregullores së Brendshme 05/2024 të Kodit të Etikës për Zyrtarët Publik në KQZ, duke mos specifikuar dispozitë konkrete, ndërsa, në arsyetimin e vendimit, organi që ka nxjerr aktin e kontestuar ka dhënë vetëm përshkrim të sjelljes së ankuesit duke cituar një konstatim të përgjithësuar, pa specifikim të fakteve relevante që arsyetoj vendimmarrjen, pse veprimi i ankuesit përben konflikt interesi dhe cila është baza ligjore që sanksionon si shkelje veprimin e kontestuar të ankuesit.

Për më tepër, akti i kontestuar nuk përmban informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike), si një nga elementet e detyrueshëm të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të LPPA-së, kështu që, mohimi i se drejtës së ankesës, bie ndesh më parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike të përcaktuar me nenin 4 të LPPA-së, ku shprehimisht thuhet se: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj*. Andaj, një akt i cili nuk përmban elementet e detyrueshëm të aktit administrativ, konsiderohet si akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52, paragrafi , nën paragrafi LPPA-së.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim së për shkak të metave të konstatuar, vendosja meritore lidhur me këtë çështje juridike-administrative nuk është e mundur, kështu që, më qëllim të kthimit të ligjshmërisë e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht, aprovoj ankesën si të bazuar, shfuqizoj vendimin e kontestuar si dhe çështjen e kthej në rishqyrtim dhe rivendosje të mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses më detyrimin që ky i fundit ta procedoj çështjen te organi kompetent për zhvillimin e procedurave disiplinore, në atë mënyrë, që ankuesit ti mundësohej dëgjimi gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore, gjegjësisht e drejta që të deklarohet lidhur me shkeljet e pretenduara, të parashtrij prova që kundër argumentojnë këto pretendime dhe së organi kompetent vetëm mbi bazën

e prova dhe fakteve të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotë të vendos lidhur më përgjegjësinë apo jo përgjegjësinë e ankuesit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të KPMSHCK-së, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1808/2025

Merlinda Ramaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, E.S;
- KQZ: Drejtori Ekzekutiv, Udhëheqësit-es të Departamentit për Operacione Zgjedhore, Edukim, Informim, Analiza dhe Trajnime dhe Udhëheqëses/it të Divizionit të Burimeve Njerëzore dhe Administrimit të Dokumenteve në Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve;
- Arkivit të KPMSHCK-së.